



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



Emërtimi i lëndës: Analize teksti B (5)

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Dr. Albana Coni, Dr. Albana Lilaj, Dr. Elvana Shtepani, Dr. Hatixhe Sejdini, Dr. Viola Shaba, Dr. Leonora Xhori

Ngarkesa: 6 kredite;60 orë mësimore;

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti III/ Semestri I

Lloji i lëndës: E detyruar

Programi i studimit: Bachelor në gjuhën angleze

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: albana.coni@unitir.edu.al,
albana.lilaj@unitir.edu.al, elvana.shtepani@unitir.edu.al, hatixhe.sejdini@unitir.edu.al
violeta.shaba@unitir.edu.al, leonora.xhori@unitir.edu.al

OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Analizë Teksti 5 është lënda, e cila i përgatit studentët të arrijnë nivelin më të përparuar të gjuhës angleze, CPE. Kjo lëndë synon të zhvillojë edhe më tej aftësitë komunikuese të studentëve duke theksuar një përgatitje dhe trajnim të plotë të studentëve. Sigurisht që kjo lëndë ka në qendër të vet të zhvilluarit më tej të katër aftësive bazë të të nxënimit, si të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit. Lënda zhvillon fjalorin si dhe kontrollon ecurinë në fushën e gramatikës, pavarësisht që kjo e fundit zhvillohet në një lëndë të veçantë. Lënda synon që studentët të bëhen të aftë të zbërthejnë tekste të llojeve dhe të regjistrave të ndryshëm që vijnë nga fusha të ndryshme të zhvillimit shoqëror e shkencor. Studentët këtu aftësohen të komunikojnë duke përdorur jo vetëm mundësitë që ofron gjuha e folur e përditshme por ofron një gamë të gjerë formash të gjuhës akademike për të përballuar me sukses sfidat e jetës.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kursi synon

1. Të konsolidojë dhe thellojë aftësitë e të lexuarit në nivelin më të lartë akademik. Këtu synohet që studentët të arrijnë të lexojnë dhe kuptojnë tekste shkencore si dhe revista apo gazeta të fushave të ndryshme të jetës në Britaninë e Madhe apo në Sh.B.A apo diku gjetkë.
2. Të aftësojë studentët në mënyrat e ndryshme të komunikimit në fusha të ndryshme të jetës duke përdorur leximin midis rreshtave, hamendësinë, parashikimin, spekulimin si dhe kuptimet e ndryshme që mer gjuha në kontekste të ndryshme duke zhvilluar me sukses edhe të lexuarit sipërfaqësor edhe të lexuarit e hollësishëm.
3. Të zhvillojë edhe më tej aftësitë e të dëgjuarit, i cili ngrihet në një shkallë të lartë duke e lidhur me detyra të veçanta sipas rastit, me materiale autentikë.

4. Të zhvillojë aftësinë e të shkruarit në nivelin Proficiency duke u përqëndruar në përzgjedhjen e informacionit specific, në lexuesin apo regjistrin që është sa më i përshtatshëm për këtë nivel.
5. Të zhvillojë më tej aftësinë e të folurit duke theksuar ndërveprimin shoqëror, gjuhën e transaksionit, negociatave dhe hipotezave.
6. Të pasurojë e t'i japë jetë fjalorit të nxënë dhe atij që kjo lëndë ofron. Deduksioni i lidhur me nxjerrjen e kuptimit nga konteksti mer rëndësi të veçantë sepse tekstet e përdorur në këtë lëndë përmbajnë informacion që shprehet me fjalë që studentët nuk i kanë dëgjuar më parë.
7. Të përmirësojë aftësitë e studentëve në fushën e stilit, atij formal dhe jo-formal

Rezultatet e të nxënit:

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë:

1. Të lexojnë, kuptojnë dhe përdorin tekste të gjinive të ndryshme dhe të fushave të ndryshme të botës akademike
2. Të kuptojnë hollësitë, kapriçot e fjalëve, frazave apo fjalive; nënkuptimet, organizimin dhe strukturën e teksteve
3. Të jenë të gatshëm të komunikojnë lirshëm me terma akademike për probleme të ndryshme
4. Të prodhojnë material të shkruar me tema të ndryshme që kanë rëndësi për zhvillimin e një vendi me fjalorin përkatës dhe duke ruajtur strukturën dhe gramatikën e duhur
5. Të përzgjedhin tekste e t'i dallojnë ato, si p.sh. gjininë
6. Të jenë të gatshëm të përballen me teste të ndryshëm të këtij niveli